



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2024:065806  
Datë: 26.03.2024  
Numri i dokumentit: 05507824

KPPP.nr.1310/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit “ECS” Environment Control System Sh.P.K., me adresë në fshatin Cërnillë, Komuna e Ferizajit, me NUI: 811855280, kundër debitorit “As Tech” Sh.P.K., me adresë rruga “Tringë Ismajli” në Prishtinë, me NUI: 810849200, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.SH. dhe B.SH. avokatë nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.153/2023 të datës 07.06.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Mubarak Shumolli me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datë 19.03.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit “As Tech” Sh.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit P.nr.153/2023 të datës 07.06.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Mubarak Shumolli, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

**A r s y e t i m**

Përmbartuesi Privat, me Urdhrit Përmbartimor P.nr.153/2023 të datës 07.06.2023, e ka caktuar përmbartimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm–faturave dhe atë: Faturës nr.9/23 të datës 15.03.2023, dhe Faturës nr.76/23 të datës 09.05.2023, duke urdhëruar debitorin që menjëherë pas pranimit të këtij urdhri, t’ia paguaj kreditorit tërësisht borxhin në shumën prej

12,880.00 Euro, me kamatë ligjore 8 % deri në pagesën e plotë, dhe shpenzimet e përmbarimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrin të Përmbaruesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi propozimin për lejimin e përmbarimit për faktin se i njëjti është i pabazuar dhe është në kundërshtim me nenin 27 dhe nenin 71 pika 1.6 dhe 1.7 të LPP-së. Më tej ka theksuar se dokumenti përmbarues si i tillë nuk mund të jetë i përmbarueshëm për faktin se në urdhrin për përmbarim nuk është treguar koha e përmbushjes së detyrimit. Ka shtuar se kreditori me asnjë provë të paraqitur nuk e ka vërtetuar se e ka bërë të kërkueshme borxhin në bazë të faturave, dhe nuk ka paraqitur deklaratë me shkrim për kërkueshmërinë e borxhit të tij, e që në rastin konkret është në kundërshtim me nenin 30 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të aprovet prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit. I ka kërkuar edhe shpenzimet e prapësimit sipas tarifës së OAK-së, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës të cilat krijohen deri në përfundim të kësaj procedure.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar se debitori me asnjë provë të vetme ska mundur të argumentojë që debitori nuk ka obligime ndaj kreditorit, dhe nuk e ka sjellur asnjë provë të vetme të argumentojë diçka tjetër në raportet kreditor dhe debitor dhe në nenin 69 par.4 theksohet se prapësimi duhet të bazohet në prova dhe ato duhet të dorëzohen me shkrim. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pabazuar, dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim, si dhe të detyrohet debitori që kreditorit t'ia kompensojë të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore, duke përfshirë shpenzimet për përgjigje në prapësim në shumë prej 312 Euro.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, përgjigjes në prapësim të kreditorit, dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata, nga shkresat e lëndës, ka evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbartim dokumentin e besueshëm/faturat- : Faturën nr.9/23 të datës 15.03.2023, dhe Faturën nr.76/23 të datës 09.05.2023, me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit, të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, dhe janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet me nënshkrimin dhe vulën e debitorit, pra rrjedhimisht debitori ka qenë i njoftuar me detyrimin që buron nga të njëjtat.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës edhe pse kreditori rezultoi fitues i këtij procesi, megjithatë ai nuk e ka bashkëngjitur në shkresat e lëndës autorizimin e përfaqësuesit, prandaj gjykata e pati juridikisht të pamundshme t’ia njoh shpenzimet procedurale.

Nga sa u theksua më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1310/23, me datë 19.03.2024

Gj y q t a r i  
Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.